



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:112583

Datë: 17.05.2024

Numri i dokumentit: 05698690

P.nr.214/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpunatoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në çështjen penale kundër të akuzuarit U... A.... nga Gjilani, për shkak të veprës penale kontrabandimi i mallrave nga neni 311 paragrafi 2 i KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.529/2024 të datës 23.04.2024, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan për dhënien e urdhrin ndëshkimor, pas konstatimit se të dhënat në aktakuzë ofrojnë bazë të mjaftuar për dhënien e urdhrin ndëshkimor, me datë 13.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan për dhënien e urdhrin ndëshkimor me shenjën P.II.nr. 529/2024 të datës 23.04.2024, andaj kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Ndaj të akuzuarit: U....A..., nga babai H... dhe nëna M..., e lindur I..., i lindur më dt.... në fshatin ... Rep. e S..., ku edhe jeton, I martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion kopshtar, me gjendje të varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.pers, të Rep së Kosovës dhe nr.personal të Sërbisë

ËSHTË FAJTOR

S E P S E

Më dt.14.04.2024, rreth orës 21.30h, përmes fshatit Dobrosin,Rep. e S.... jashtë vendkalimit të autorizuar kufitar ka hy në Republikën e Kosovës, në fshatin Stublinë, duke kontrabanduar mallëra, në atë mënyrë që Njësia e Task Forcës gjatë vëzhgimit të terrenit në brezin kufitar, vëren duke hy në mënyrë ilegale veturën e markës "Peugeot", të cilën e vëzhgon dhe përcjell

dhe në hyrje të fshatit Dobërçan, arrijnë ta ndalin veturën Pikap të markës "Peugeot", ngjyrë e kaltër, me targa BU-039-AV, që po e ngiste i pandehuri Urim Asani dhe gjatë kontrollit të veturës nga Njësia Task Forcës janë gjetur 61x16 copë Plazma(keks) të bluara, dhe atë 971 copë në sasi nga 300 gr, pa dokumentacion përcjellës, i cili mall është kontrabanduar nga Republika e Serbisë, në Republikën Kosovës, me qëllim përfitimi, pa leje, pa autorizim dhe dokumentacion përkatës, kështu që i pandehuri me veprimet e tij ka kontrabanduar mallëra në vlerë 1.267.82€, duke e shmang pagesën e tarifave të detyrueshme doganore në vlerë 377.81€, për të cilën vlerë ka dëmtuar buxhetin e Republikës së Kosovës.

-me çka ka kryer veprën penale, kontrabandimi i mallrava nga neni 311 par. 2 i KPRK-së,

Prandaj, në bazë të nenit 4,31,38,40,43,të KPRK-ës si dhe të nenit 495 par. 1.1 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

DENIM ME GJOBË

Ashtu që i akuzuari dënohet me dënim me gjobë në shumë prej **300 (treqind e euro)€**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguajë brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë atëherë dënimi me gjobë me pajtimin me të akuzuarit do të zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20€ (njëzet euro) ndërsa nëse i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë me punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20€(njëzet euro) do të caktohet një ditë burgim.

Konfiskohet –.....në bazë të nenit 311 paragrafi 6 i KPRK-së.

Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë shumën prej 20€, si dhe në emër të kompensimit për viktimat e krimit të paguaj shumën prej 20€, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën P.II.nr.329/2024 të datës 23.04.2024, për shkak të veprës penale të lartcekur dhe njëherësh gjykatës i ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe shqiptimin e dënimit me gjobë me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me besueshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtet e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykuese me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPK-së dhe konform nenit 495, par. 1, 2 dhe 3 të KPP-së, dhe vendosi që të pranohet kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor si në dispozitiv.

Kjo gjykatë, konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, janë bazë për dhënien e urdhërit ndëshkimor: deklarata e të pandehurit Urim Asani, fotografi nga vendi i ngjarjes, vërtetimi për sekuestrimin e përkohshëm të mallrave i dt.14.04.2024 me nr të rastit 2024-YEC-016, formulari i pranim dorëzimit të mallit i dt.015.04.2024 , me nr.prot.109/2024, raporti i shpejtë i dt.14.04.2024, raporti i oficerit Liridon Kastrati i dt.14.04.2024 dhe raporti i oficerit Sabedin Kryeziu i dt.14.04.2024, urdhëri i përkohshëm i ndalimit PPN.II.nr.212/2024 i dt.16.04.2024, kërkesa PPN.II.212/2024 por konfirmim retroaktiv të kontrollit dhe sekuestrim të përkohshëm e dt.16.04.2024, aktvendimi për aprovim retroaktiv të kontrollit dhe sekuestrim të përkohshëm PN.18/2024 i dt.16.04.2024, kërkesa për urdhër ndalues përfundimtar PP.II.529/2024 e dt.19.04.2024, urdhri ndalues përfundimtar PN.nr.18/2024 i dt.22.04.2024, raporti i doganës për vlerësimin e mallrave, si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Në bazë të nenit 311 paragrafi 6 i KPRK-së, janë konfiskuar- 61x16 copë plazma keks të bluara dhe 971 copë në sasi nga 300 gram.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 495 paragrafi 1,2 dhe 3 të KPP-ës gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
P.nr.214 /2024 me datë 13.05.2024

Gjyqtari

Veli Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri mund të paraqes kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranim të të njëjtit.